

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje e thellë në palestra në objektet publike”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45212222-8 –Punime ndërtimi për palestra

VLERA E FONDIT LIMIT: 25 651 244.62 *(njëzet e pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet e katër pikë gjashtëdhjetë e dy)* **Lekë pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, *(i ndryshuar)*.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me **Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente**, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet certifikata ISO e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar

në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me **Çertifikatën SSH EN ISO 14001:2015 ose ekuivalente**, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet certifikata ISO e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo certifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Ky certifikim ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Ky certifikim ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me **Çertifikatën SSH EN ISO 45001:2018 ose ekuivalente**, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet certifikata ISO e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. është kërkuar kjo certifikatë pasi ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë përfshirë gjithë aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorë

ekonomikë, të cilët do të ekzekutojnë këto kontrata shërbimi. Një OE i certifikuar sipas këtij standardi është në gjendje të:

- Krijojë kushtet më të mira të punës në gjithë organizatën e tij;
- Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre;
- Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën Joproductive;
- Përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune;
- Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve;

Të gjitha këto janë garanci se OE i shpallur fitues i cili është i certifikuar sipas këtij standardi ka kapacitetet e duhura për realizuar me sukses kontratat me AK-të. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.1.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me **Çertifikatën SSH EN ISO 3834-2:2021 ose ekuivalente**, lidhur me sistemet e menaxhimit të saldimit me shkrirje të materialeve metalike, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet çertifikata ISO e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues që merr persiper punime saldimi, duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (strukturat metalike ku ka edhe saldime), me ritjen e cilësisë së ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 ose ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të cojnë në carje të nyjeve.

2.1.5 Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet çertifikata e akreditimit përkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr.667, datë 29.07.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit". Çertifikatat e lëshuara nga ente certifikuese të pa akredituara nuk garantojnë efikasitetin dhe sigurinë për kërkesat e cilësisë të cilat autoriteti kontraktor i kërkon për realizimin e kontratës.

2.1.5 Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë çertifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Udhëzimin nr.7, datë 10.01.2017 “Për disa shtesa në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Në përcaktimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” (të ndryshuar), ku citohet“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.... Përcaktimi i vlerës së kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, operatori ekonomik ofertues duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **3 860 272** (tre milion e teteqind e gjashtedhjetë mije e dyqind e shtatedhjetë e dy) **Leke pa Tvsh**, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **15 441 088** (pesembedhjetë milion e katerqind e dyzet e nje mije e tetedhjetë e tete) **Lekë pa Tvsh**.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatorit ekonomik ofertues do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Fatura tatimore perkatëse.

2.3.3 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

2.3.4 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 5 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM Nr.285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjisë, në bazë të VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (të ndryshuar), e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme në ndërtim:

- **NP-3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Shenim: Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi 2.3.5: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 2, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 6 , gërma a) e VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “.....Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.....” Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 3 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.	A (0- 20 milionë lekë)
NS-1A	Punime per prishjen e ndertimeve .	Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve	A (0- 20 milionë lekë)
NS-4A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.	A (0- 20 milionë lekë)

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune noteriale e vlefshme;
- b) Diplomë.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi 2.3.6: *Kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një numër mesatar të punonjësve të siguruar jo më pak se **32** (*tridhjetë e dy*) **punonjës** të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore.
- b. Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi

Shënim: Ky kriter (2.3.7) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi 2.3.7: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (*i ndryshuar*) dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **32 punonjës** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore)

Bazuar në kohën në dispozicion për realizimin e punimeve dhe nga zbërthimi i manualeve dhe analizave të çmimeve, u përlllogaritën orët e punës dhe punëtoria e nevojshme për realizimin e këtij investimi, objekt i prokurimit.

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është min **32 punonjës**.

2.3.8 Operatorët ekonomikë ofertues, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si dhe te figurojnë ne listepagesa per muajin e fundit të deklaruar, konkretisht si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)

Për punonjesit e mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune noteriale e vlefshme, Diplomën Universitare.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi 2.3.8: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik te punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore sipas parashikimeve ne projekt-preventiv.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si staf teknik punonjes, te pajisur me Diplomë/certifikate profesionale që vërteton nivelin e kualifikimit profesional, lëshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, te njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe te figurojne ne listepagesa per muajin e fundit të deklaruar, si më poshtë vijon;

- Teknik Ndërtimi 1 (një)
- Punonjës për shtrim parketi 3 (tre)
- Punonjës marangoz 2 (dy)
- Elektracist 1 (një)
- Punonjes i izolimeve (Hidroizolues) 4 (katër)

- Murator/Suvatues 2 (dy)
- Punonjes per dyer/dritare 2 (dy)
- Bojaxhi 4 (katër)
- Specialist ndertimi (per punime te pergjithshme) 1 (një)
- Montataor/Specialist te konstruksioneve metalike 1 (një)
- Shofer 2 (dy)

Për punonjesit e mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme,
- Diplomë/certifikate profesionale lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.

Shenim: Për punonjësit shoferë që janë të kontraktuar me kontratë pune (*respektivisht për mjetet e marra me qera*), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi 2.3.9: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te jane bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport).Numri i

punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me kontratë pune, certifikate/diplome profesionale që vërteton nivelin e kualifikimit, si dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën e fundit të deklaruar si më poshtë;

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").
- 2 (dy) punonjës të cilët të jenë pajisur me certifikatën e trajnimit "Për punimet në lartësi" ose ekuivalente, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për muajin e fundit dhe në vazhdim. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës së vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente certifikuese të akredituara/licensuara.
- 1 (një) punonjës saldator, i pajisur me certifikim sipas standardit SSH EN ISO 9606-1:2017 ose ekuivalente, për kryerjen e punimeve të saldimit, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesipërm, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi 2.3.10: Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6 germa c), të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i cili përcakton se..... Neni 7....Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit....1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion...., dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e

ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi..

Argumentimi 2.3.10: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohet të jete ne kantier per trajnimin e punonjesve te kantierit me qellim minimizimin e aksidenteve ne pune.
- 1 (një) punonjës saldator, i certifikuar sipas standardit SSH/EN ISO 9606-1 “Prova kualifikimi për saldatorët – Saldimi me shkrirje”, është kërkuar me qëllim garantimin e cilësisë dhe sigurisë së punimeve të saldimit, të cilat janë pjesë integrale e zërave të preventivit, konkretisht të zërit të punimeve “F.V. konstruksione metalike të thjeshta”.

2.3.11 Deklaratë për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i materialit	Modeli	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
1.	Parketi Sportiv		

- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori të autorizuar, ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për materialet parket druri. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik

ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

- Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet; parket druri, duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Katalogët ose skedat teknike duhet të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën Shqipe.

Argumentimi 2.3.11: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe ,në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rëndësia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që në këtë fazë krijon një lehtësi për Autoritetin Kontraktor pasi në këtë mënyrë siguron cilësinë, specifikimet teknike të këtyre pajisjeve e cila është lehtësisht e kontrollueshme gjatë fazës së zbatimit në referencë me dokumentat e paraqitura që gjatë kualifikimit. Nepermjet dorëzimit të këtij dokumentacioni që në fazën e vlerësimit asnjë OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit që gjatë zbatimit të furnizoje të njëjtin mall të certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t’i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit

Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në menyre të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kërkesës me siper garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.12 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor një mostër për parketin, me përmasa 1x1 .

- Mostrat e paraqitura duhet të jenë prerje ku të evidentohen të gjitha elementet, detajet dhe aksesoret sipas specifikimeve teknike.

Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s’kualifikim.

Argumentimi 2.3.12: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 39, pika 8, ku përcaktohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurrohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”, si dhe neni 40, pika 6/a, ku përcaktohet se, “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

2.3.13 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht si më poshtë vijon:

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
-----	--------------------------------------	----------------	---------

1.	Kamionçine kapaciteti mbajtës 3.5- 5 ton	2 copë	Pronësi ose me qira
2.	Gjenerator/Motogjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
3.	Depozite uji	1 copë	Pronësi ose me qira
4.	Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qira
5	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	1 copë	Pronësi ose me qira
6	Makineri për lustrimin e parketit	1 copë	Pronësi ose me qira
7	Makineri Vijezi	1 copë	Pronësi ose me qira
8	Skeleri metalike	100 m2	Pronësi ose me qira
Nr.	Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia minimale	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	32 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishtë	32 copë	Pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme ≥ 5 kg	5 copë	Pronësi ose me qira
4	Tabela Sigurimi Teknik	5 copë	Pronësi ose me qira
5	Kuti e Ndhmës së shpejtë	5 copë	Pronësi ose me qira

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse të qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklaratës dhe verifikimin e makinerive dhe pajisjeve në terren. Në rast deklarimi të rreme do të te veprohet në përputhje me nenin 13 pika 3 germa a të ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 i ndyshuar "për prokurimin publik".

Shënim: Ky kriter (2.3.13) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë

autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi 2.3.13: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Nr.	Emri i mjetit	Njesi	Sasi /cope	Argumentimi
1	Kamionçine kapaciteti mbajtës 3.5- 5 ton	copë	2	Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5–5 ton shërben për transportin e materialeve të ndërtimit, pajisjeve dhe punonjësve në objekt, në funksion të realizimit të punimeve sipas preventivit dhe grafikut të punimeve.
2	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Eshte i nevojshem per Per te patur energji elektrike te pandërprere ne kantier
3	Depozite uji	copë	1	Eshte i nevojshem per mbajtjen e ujit per punime te ndryshme
4	Matrapik	copë	2	Eshte i nevojshem per prishje te ndryshme, suvatimi, mure etj
5	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	copë	1	Eshte i nevojshem per qendrimin e stafit inxhinierik gjate proceseve te ndryshme

6	Makineri për lustrimin e parketit	copë	1	Eshte e nevojshme per rashinimi dhe lustrimin e parketit pasi te montohet ne palester
7	Makineri Vijezi	copë	1	Eshte i nevojshem per per te konturuar hapsirat sportive sipas parametrave te fushes per lojra me dore.
8	Skeleri metalike	m2	100	Eshte e nevojshme per te aksesuar ne lartesine ku do te kryehen punime per zevendesimin e ulluqeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt **“Mirëmbajtje e thellë në palestra në objektet publike”**, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

II.1 Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: **“Mirëmbajtje e thellë në palestra në objektet publike”**, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Për caktimin e zërave të punimeve të nevojshëm janë marrë në konsideratë:

Grupi i Punës ka administruar studim-projektimet e hartuara për mirëmbajtjet e thella në disa palestra dhe ambiente të brendshme, referuar kontratave të lidhura, në të cilat janë përcaktuar objektet shkollore dhe nevojat për riparime të thelluara në ambientet e brendshme sportive të tyre. Është marrë për prokurim projekti dhe preventivi i zbatimit për palestrat e objekteve shkollore, pasi këto palestra janë ndër më të amortizuara.

Nga studim-projektimi i hartuar, është marrë për prokurim projekti dhe preventivi i zbatimit për një tjetër palestër të objektit shkollor. Këto projekte kanë trajtuar problematikat aktuale të palestrave në objektet e sipërcituara, ku zërat kryesorë të punimeve të propozuara janë përmirësimi i standardeve të mësimdhënies përmes instalimit të aksesorëve sportivë, zëvendësimi i shtresave me amortizim të përshtatshëm në dysheme, sistemet elektrike dhe të ndriçimit, si dhe riparimet e hidroizolimit, suvatim dhe lyerje të këtyre ambienteve sportive.